



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 798/1 Prot.

Tiranë, më 26.05.2021

**V E N D I M**

**Nr. 86, Datë 26.05.2021**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 144, datë 01.12.2020, të paraqitur nga G.GJ kundër L.B, zv/Kryetar i Bashkisë Berat dhe E.D, Kryetar i Bashkisë Berat, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjes politike<sup>1</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe me e-mail-in datë 04.12.2020, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Në datë 01.10.2018, ka filluar punë pranë Bashkisë Berat, në pozicionin si Specialist i Kontrollit të Zhvillimit të Punëve Publike dhe Private, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Në muajin tetor të vitit 2019, kanë filluar debatet e para me Zv/kryetarin e Bashkisë, L.B, lidhur me qëndrimin jashtë orarit të punës, duke i ngarkuar detyra të cilat ishin jashtë detyrave të tija funksionale, sipas rregullores së brendshme të bashkisë. Në nëntor të 2019, ditë e premte, rreth orës 16.00, ka debatuar me L.B pasi ai nuk mund të qëndronte jashtë orarit të punës dhe zv/kryetari i ka kërkuar drejtoreshës së

<sup>1</sup> Pretendim i ngritur nga ankuesi, gjatë seancës dëgjimore të datës 25.02.2021. Referuar Formularit të Anëtarësimit nr. 0000003299, datë 16.01.2017, G.Gj është anëtar i subjektit politik, LSI, Dega Berat. Referuar formularit, Konfirmim Anëtarësie, nr. 0000009631, datë 03.09.2020, G.Gj është konfirmuar si anëtar i LSI-së. Referuar Vërtetimit datë 01.02.2021 të Kryetarit të LSI Berat, vërtetohet se G.Gj është aktivizuar publikisht në veprimtaritë politike të LSI-së dhe ka qenë vëzhgues në zgjedhjet e vitit 2017.

burimeve njerëzore të asaj kohe, E.Ç që t'i vendoste masë disiplinore. Në dijeninë e tij E.Ç e ka kundërshtuar me argumentin se propozimi për masë bëhej nga eprori direkt, dhe drejtori i tij në atë periudhë ishte S.Dh. Ankuesi informon se kanë debatuar përsëri në grupin e komisionit të licencimit të karburanteve, ku L.B, në pozicionin si Kryetar Komisioni, e detyronte që ti gjente një material që sipas tij i nevojitej komisionit, por në të vërtetë ishte për përfitimin personal të L.B, pasi nuk kishte të bënte me dokumentacionet e kërkuara me ligj, por me standardet e projektimit të karburanteve, pra i nevojitej një projektuesi dhe L.B është me profesionin, arkitekt. Pas debatit, e ka hequr nga grupi i komisionit të licencimit të karburanteve dhe me Urdhërin Nr.10, datë 13.01.2020 të Kryetarit të Bashkisë, është vendosur anëtar në grupin e punës për verifikimin e hyrje-daljeve të karburanteve. Përgjegjësia në grupin e punës është e kryetarit të grupit, por edhe në këtë grup pune, L.B ka propozuar vendosjen e masës disiplinore ndaj tij me arsyen se po pengonte punën e grupit. Propozimi për masë si dhe disa propozime të tjera, janë kundërshtuar nga ish drejtori S.Dh, i cili, gjithashtu ishte në konflikt me zv/kryetarin dhe nuk kishte argument që ti vendoste masën disiplinore. Ankuesi shpjegon se për shkak të formimit të tij profesional, ka pasur më shumë kontakte dhe konflikte me L.B, pasi deri në muajin qershor 2020, ishte i vetmi arkitekt në institucion, dhe L.B vetëm me punën e tij mund të kapej, duke e akuzuar gjithnjë se nuk ishte sipas “standardit”. Në muajin shkurt 2020, drejtorin e tij e larguan nga ai pozicion dhe L.B u komandua në pozicionin si drejtor. Ditën e parë që L.B është vendosur Drejtor i Komanduar i ka dhënë masën “Tërheqje vëmendje” dhe prej asaj dite, në një farë mënyre atij ju hap rruga për propozimet e masave disiplinore. Pas kësaj periudhe, L.B filloi ta shmangte nga detyrat e tija funksionale dhe detyrat ia ngarkonte vetëm koleges së tij e cila është në të njëjtin pozicion, ndërsa atij i jepte urdhëra verbal për të cilat asnjëherë nuk ishte i kënaqur me “standardin”. Mbi bazën e këtyre pretendimeve i kanë dhënë masën disiplinore “Vërejtje”, në datë 05.05.2020, masë të cilën ka kërkuar që të rishikohej (shkresë nr.2002/2, datë 06.05.2020) por që nuk ka marrë përgjigje. G.GJ me shkresën nr. 3493, datë 22.07.2020 i është drejtuar përsëri Kryetarit të Bashkisë në të cilën e ka vënë në dijeni se L.B po e shmangte nga detyrat e tija funksionale duke e diskriminuar atë. Por dhe për këtë shkresë nuk ka marrë përgjigje. Ankuesi informon se me shkresën nr. 3493/1, datë 04.09.2020 i është drejtuar përsëri Kryetarit të Bashkisë në të cilën ka rikërkuar marrjen e masave për ndërprerjen e diskriminimit dhe viktimizimit të tij nga ana e Zv/kryetarit të Bashkisë, L.B. Bashkia Berat me shkresën nr. 3493/2, datë 01.10.2020 i ka kthyer përgjigje ankuesit në të cilën e ka sqaruar se ankimi i tij nuk është pranuar për shkak se ai nuk legjitimohet në ngritjen e ankimit dhe mjetet ligjore administrative nuk përfshijnë objektin e ankimit të bërë nga G.GJ. Ankuesi informon se pas kërkesës së tij, L.B e ngarkonte me disa prej detyrave funksionale dhe me shumë detyra të tjera jashtë funksionit ose për të cilat kompetencë dhe detyrë funksionale, i kishin punonjës të tjerë të cilët favorizoheshin nga L.B, duke e mbingarkuar atë, me këto detyra. Në muajin tetor, ka debatuar me L.B, pasi pretendonte se ai pengonte punën e grupeve të komisionit dhe se duhej të qëndronte jashtë orarit, ndërkohë që një fundjavë më përpara ishte paraqitur në punë të shtunën, në mënyrë që të mos bëhej pengesë. Kur është paraqitur në punë, ka konstatuar që jo të gjithë anëtarët e komisionit ishin prezent, pra, detyra nuk kishte qenë aq urgjente sepse disa favorizoheshin dhe disa akuzoheshin se pengonin punën. Pas këtij debati, në datë 07.10.2020,

*për herë të parë Kryetari i Bashkisë e ka thirrur në zyrë në prani dhe të zv/kryetarit, L.B. Në atë takim nuk i është dhënë mundësia për të folur dhe për t'u shpjeguar. Gjithashtu ankuesi informon se L.B në pozicionin si Drejtor i Komanduar, nuk e pret asnjëherë në zyrë për sqarime apo konsultime për çështje të punës, por e sulmon lidhur me realizimin e detyrave, ndërkohë që të gjithë kolegët e tjerë të drejtorisë mirëpreiten në zyrën e L.B, për bashkëpunime dhe diskutime. Ankuesi informon se në datë 24.08.2020 ka kërkuar 5 ditë pushim për një rast vdekje në fami lje, por nuk ka marrë përgjigje, gjithashtu dhe në datë 13.11.2020 ka kërkuar shfrytëzimin e lejes vjetore por nuk ka marrë përgjigje zyrtare. Ankuesi informon se në muajin tetor 2019 ka plotësuar vitin si nëpunës civil dhe sipas ligjit duhej që ti konfirmohej statusi. Me shkresën nr. 1471, datë 11.03.2020 i është drejtuar Kryetarit të Bashkisë në të cilën ka kërkuar që ti konfirmohej statusi i nëpunësit civil pasi plotësonte kushtet e trajnimit nga ASPA dhe vlerësimin të punës nga eprori direkt në tetor 2019, por nuk ka marrë përgjigje për kërkesën e tij. Ankuesi informon se në trajnimin e ASPA-s kanë qenë rreth 11 nëpunësa, të cilët e plotësonim afatin njëvjeçar në periudha të ndryshme. Pas ardhjes në detyrë të Kryetarit Bashkisë, E.D, kanë qenë rreth 5 ose 6 nëpunësa nga të cilët ai nuk është konfirmuar, kolegja D.S ka dhënë dorëheqjen, për kolegen A.Ç nuk ka informacion, ndërsa nëpunësit e tjerët janë konfirmuar. Ankuesi shprehet se situata dhe mjedisi armiqësor, përcmues e frikësues i krijuar nga ana e eprorëve të tij i ka sjellë shqetësime dhe probleme në gjendjen psikologjike, e vërtetuar kjo me fletët e vizitave tek mjeku neuro-psikiatër ku ai dhe aktualisht është nën trajtim me medikamente”.*

Me e-mail-in datë 02.04.2021, subjekti ankues ka pretenduar diskriminim nga ana e Bashkisë Berat, gjatë procesit të ristrukturimit të stukturës organizative të bashkisë, duke i suprimuar pozicionin dhe zgjidhur marrëdhëniet e punës, për shkak të bindjes politike.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe që të ndalohet situata shqetësuese dhe të trajtohet si të gjithë punonjësit e tjerë, pa u diferencuar.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së<sup>2</sup>, të ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët

<sup>2</sup> Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

*publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me shkakun e pretenduar nga ankuesi.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 144, datë 01.12.2020, të G.GJ u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/4 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1669/1, datë 09.12.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Bashkia Berat për ankesën e bërë nga G.GJ si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
  - Kopje të masave disiplinore të dhëna ndaj ankuesit, kundërshtimeve të tij dhe përgjigjeve të dhëna nga institucioni.
  - Kopje të të gjithë urdhrave të punës të lëshuar nga L.B dhe raporteve të dhëna nga ankuesi në përgjigje të detyrave të caktuara, nga muaji shkurt 2020 deri në datë 30.11.2020.
  - Kopje të relacionit të grupit të punës për shqyrtimin e ankesës për diskriminim në punë të G.GJ, në datat, 22.07.2020 dhe 04.09.2020.
  - Kopje të vendimit të emërimit të L.B në detyrën e zv/kryetarit të Bashkisë dhe të Drejtorit të Komanduar të Drejtorisë së Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve.
  - Kopje të vlerësimit të punës së ankuesit për vitet: 2018 dhe 2019.
  - Kopje të plotë të dosjes personale të G.GJ.
  - Kopje të procesverbalit të takimit të zhvilluar në datë 07.10.2020, mes Kryetarit të Bashkisë, zv/kryetarit, L.B dhe ankuesit (nëse ka).
  - Kopje të përgjigjeve të dhëna nga ana e Bashkisë për lejet e kërkuara nga ankuesi në datat, 24.08.2020 dhe 13.11.2020.

- Kopje të të gjitha akteve të konfirmimit të nëpunësit civil në Bashkinë Berat nga data 01.10.2019 deri në datë 01.12.2020.

Me shkresën nr. 5896/1, datë 18.12.2020, të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Bashkia Berat në mes të tjerash informoi se: “G.GJ, është punonjës pranë Bashkisë Berat, në pozicionin Specialist për Monitorimin e Investimeve, pranë Drejtorisë së Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve. Ai ka filluar marrëdhëniet e punës pranë institucionit, prej datës 01.10.2018 e në vazhdim. Ankuesi pretendon se ka filluar debatet e para me zv/Kryetarin e Bashkisë, lidhur me kryerjen e detyrave jashtë detyrave të tij funksionale, si dhe qëndrimin jashtë orarit zyrtar të punës, për kryerjen e detyrave të caktuara nga eprorët. Bazuar në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, neni 89 theksohet se: “Nëse rrethanat kërkojnë kryerjen e orëve shtesë të punës, punëdhënësi mund t’i kërkojë punëmarrësit për të kryer orë shtesë pune, për aq kohë sa është e mundur dhe e nevojshme, si dhe duke marrë parasysh kushtet vetjake dhe familjare të punëmarrësit”. Ankuesi pretendon se është diskriminuar lidhur me këtë fakt, por detyrat që mund të zgjasin, në disa raste edhe jashtë orarit zyrtar të punës, ishin për të gjithë grupin e punës dhe jo vetëm në drejtim të ankuesit, sikundër ai pretendon. Gjithashtu, informohet se qëndrimi jashtë orarit zyrtar ka ndodhur në raste sporadike dhe për shkak të tejkalimit të afateve të realizimit të detyrave të ngarkuara, për realizimin e projekteve. Pra, në qoftë se ankuesi dhe anëtarët e tjerë të grupit të punës do t’i përmbushnin detyrat e tyre brenda orarit zyrtar, atëherë nuk do të ishte e nevojshme qëndrimi jashtë orari. Ankuesi në asnjë rast nuk është viktimizuar, apo diskriminuar, sikundër pretendon, madje në raport me punonjësit e tjerë është favorizuar, pasi vetë ankuesi deklaroi se një pjesë e detyrave, që për përmbajtjen e tyre i takojnë të realizohen nga ankuesi, i siglohen në shkresa, koleges së tij për detyrat që i takojnë atij. Pra, ankuesi për shkak të aktivizimit në komisione të ndryshme i është lehtësuar ngarkesa e punës, duke ia kaluar një pjesë të detyrave, koleges së tij. Sqarohet se, Kryetari dhe zv/Kryetari i Bashkisë ka lehtësuar ngarkesën e punës së ankuesit, për t’i dhënë prioritet dhe fokus realizimit të një detyre tepër të rëndësishme për interesin publik, siç është realizimi i disa projekteve (të zvarritura në kohë), të cilat kërkonin zgjidhje imediate. Kjo situatë nuk ka qenë vetëm për ankuesin por për të gjithë anëtarët e komisionit, që mbulonin këto detyra, që lidheshin me projektet e sipërpërmendura. Në lidhje me rastin e muajit nëntor 2019, përmendur nga ankuesi, nga kërkimet, nuk rezultoi të ketë ndonjë dokumentacion që të vërtetojë pretendimin e tij. Ankuesi vetë pohon faktin se pavarësisht se ai “sulmohej” pa të drejtë nga Zv. Kryetari i Bashkisë ai kishte mbështetjen e ish-drejtorit të kohës në fjalë, pasi edhe ky i fundit, sipas ankuesit, ka qenë në konflikt të vazhdueshëm me Zv. Kryetarin, e për rrjedhojë ka qenë vazhdimisht në mbrotje të ankuesit. Lidhur me kryerjen e detyrave jashtë funksionit, ankuesi vetë thekson faktin se për një periudhë kohe ka qenë i vetmi punonjës me formim profesional të fushës së arkitekturës. Lidhur me këtë informohet se, Kryetari i Bashkisë dhe zëvendësat e tij kanë të drejtë, bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të urdhërojnë kryerjen e detyrave për realizimin e funksioneve të dhëna nga ligji, njësisë së qeverisjes vendore. Punonjësit nuk janë të detyruar vetëm për kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në



rregullore, sikundër pretendon ankuesi, por duhet të kryejnë dhe detyra të tjera, të ngarkuara nga ligje të posaçme, të cilat janë detyrim ligjor si për Bashkinë Berat, ashtu edhe për punonjësit e saj. Masat disiplinore që i janë dhënë ankuesit, respektivisht ajo e datës 21.02.2020 “Tërheqje vëmendje”, dhe me Urdhërin nr. 260, datë 05.05.2020 “Dhënie masë disiplinore nëpunësit civil”, në të dy rastet kanë qenë me motivacion “Për mos realizim në kohë të detyrave të ngarkuara”. Pra, nuk ka patur ndonjë element diskriminues për ankuesin, pasi vetë fakti se realizimi i projekteve ishte jashtë afateve kohore ishte real dhe e justifikonte dhënien e një mase të tillë disiplinore. Kjo ka ardhur për shkak dhe të profilit të detyrave të ankuesit në komisione (lidhur me profilin e tij), prej nga inicioheshin vonesat në realizimet e projekteve. Në Ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil”, parashikohet se: “Nëpunësi ka të drejtë të kundërshtojë vetëm zbatimin e urdhërave të kundërligjshëm”. Instucionet nuk mund të realizojnë detyrat e ngarkuara nga legjislacioni me punonjës jashtë administratës së vet, pasi kjo do të përbënte shkelje ligjore dhe njëkohësisht shkaktimin e një dëmi ekonomik real. Lidhur me pretendimin se diskriminohet duke i ngarkuar detyra të cilat ishin detyra funksionale të punonjësve të tjerë, argumentohet se ankuesi në asnjë rast nuk i është ngarkuar ndonjë detyrë në mënyrë individuale, por minimalisht janë ngarkuar 2 ose më shumë punonjës së bashku me të, në funksion të bashkëpunimit brenda institucionit dhe në rastet kur në drejtori të ndryshme ka patur mungesë të burimeve njerëzore, ose çështja (detyra e ngarkuar) lidhej ngushtësisht me formimin dhe pozicionin e punonjësit. Bashkëpunimi i kërkuar ankuesit, është detyrim ligjor dhe parashikohet në nenin 51, pika 3, të Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, që është ligji bazë i funksionimit të drejtorisë ku punon ankuesi. Ankuesi është i paqartë në pretendimet e tij, pasi ai herë thotë se është shmangur nga detyrat që duhej t’i ngarkoheshin dhe herë të tjera thekson se ka qenë i mbingarkuar me detyrat e dhëna. Theksojmë se, gjithë pretendimet e ankuesit lidhen me detyrat që ankuesi ka si anëtar i Komisionit të Shpronësimeve dhe detyrave të tjera që lidheshin me projekte të ndryshme. Pra, ankuesi në asnjë moment nuk ka qenë i pambuluar me detyra dhe për më tepër jashtë profilit të formimit të tij. Lidhur me pretendimet e ankuesit se nuk ka mundësi të komunikojë me Kryetarin dhe z.v.Kryetarin e Bashkisë, sqarohet se nuk ka asnjë provë që të vërtetojë këtë fakt apo të kundërtën, pasi barra e provës, sipas legjislacionit në fuqi, i takon ankuesit për ta vërtetuar. Lidhur me pretendimin për dhënien e lejeve, theksohet se si ankuesit, ashtu dhe anëtarëve të tjerë të komisioneve ku ka pasur vonesa në afatet e realizimit të tyre, nuk i është dhënë leja vjetore. Pra dhe në këtë rast nuk ka elementë diskriminimi kundrejt ankuesit. Në “Kodin e Punës” leja vjetore i jepet punëmarrësit në marrëveshje me punëdhënësin, (në funksion të ecurisë së proceseve të punës në institucion) dhe këtë të drejtë punëmarrësi mund ta shfrytëzojë deri më 31 mars të vitit pasardhës. Pra, afati për kryerjen e lejes vjetore nga ankuesi nuk është ezauruar, por akordimi i saj jepet në bazë të vullnetit të shprehur nga të dyja palët (punëdhënës-punëmarrës). Lidhur me pretendimin për leje për rast vdekje, në “Kodin e Punës” parashikohen rastet konkrete se kur mund të përfitohet një leje e tillë, e për këtë ankuesi nuk ka depozituar ndonjë dokument që të vërtetojë faktin. Lidhur me pretendimin për fitimin e statusit të nëpunësit civil, informohet se në zbatim të ligjit “Për nëpunësin civil”, me përmbushjen e afateve ligjore punonjësi fiton

*automatikisht statusin e nëpunësit civil. Prandaj pretendimi është i pabazë, pasi ankuesi e gëzon statusin, sepse institucioni e ka miratuar në heshtje këtë fakt. Kjo është dhe një prej mënyrave, të njohura nga ligji, të miratimit të statusit për nëpunësit civil”.*

Në përgjigje të shkresës së Bashkisë Berat, G.GJ në datë 30.12.2020 në mes të tjerash ka deklaruar<sup>3</sup> se: “Kohëzgjatja e punës tej orarit 8 orë në ditë nuk është parashikuar në kontratën e punës. Detyrimi që i është bërë për të punuar tej orarit 8 orë në ditë, është në kundërshtim të “Kodit të Punës”, neni 8/1/2, neni 83, neni 89, neni 91/1/2. Lidhur me favorizimin e tij, sqarohet se zv/Kryetari e ka shmangur qëllimisht nga kryerja e detyrave të tija funksionale duke ia deleguar me shkresë koleges së zyrës. Zv/kryetari nuk ka patur si qëllim favorizimin e tij. Ky fakt është lehtësisht i vërtetueshëm me shkresën nr. 4067, datë 01.09.2020, ku ndërkohë që zv/kryetari e “favorizonte”, për detyrat që nuk i ngarkonte atij por koleges, ka filluar procedim disiplinor në emrin e tij, për mos ndjekje të atyre detyrave (bashkangjitur shkresa nr. 4067, datë 01.09.2020). Ankuesi informon se ka depozituar pranë bashkisë dy shkresa (nr. 2002/2, datë 06.05.2020 dhe nr. 3493, datë 22.07.2020) drejtuar Kryetarit të Bashkisë ku ka kërkuar të trajtohet nga zv/kryetari njësoj si kolegët e tjerë, konform Kodit të Punës, neni 9/6 për ndalimin e diskriminimit. Asnjë nga këto kërkesa nuk është marrë parasysh dhe trajtimi i tij ka vazhduar po njësoj, duke shkelur nenin 9 të Kodit të Punës (bashkangjitur shkresa nr. 2002/2, datë 06.05.2020, shkresa nr. 3493 datë 22.07.2020). Ankuesi informon se nëse favorizimi ka qënë për arsyet e përmendura nga Bashkia Berat, do të vazhdonte edhe më tej, por ka ndaluar në momentin që ai ka depozituar shkresën nr.3493/1, datë 04.09.2020. Pas kësaj shkrese, nga i favorizur, ai është mbingarkuar me detyra, ku mund të numëronte rreth 16 shkresa për ngarkim detyrash, brenda dhe jashtë detyrave të tija funksionale, për një periudhë kohe 3 javore (20.10.2020-09.11.2020). Disa prej detyrave kanë qënë hartime projektesh, pra punë voluminoze, dhe në drejtorinë e tyre është edhe një punonjës tjetër në të njëjtin profesion si ai. Ngarkimi i detyrave jashtë detyrave funksionale dhe shmangia nga detyrat e tija vazhdon akoma aktualisht dhe si provë paraqet shkresën nr. 6141, datë 24.12.2020, me anë të së cilës ngarkohet me detyra të cilat janë kompetencë e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit dhe me shkresën nr. 6079, datë 22.12.2020, në të cilën përjashtohet nga ndjekja e investimit publik, detyrë e cila i ngarkohet nga Rregullorja e Brendshme e Bashkisë Berat (bashkangjitur shkresa nr. 6141, datë 24.12.2020, shkresa nr. 6079 datë 22.12.2020). Lidhur me pretendimin e mbrojtjes së bërë nga ish–drejtori, ankuesi deklaroi se në asnjë rast nuk është shprehur se ka pasur mbrojtje nga ana e ish–drejtorit, por njohja e mirë e legjislacionit për shkak të vjetërsisë dhe eksperiencës në institucion, i ka dhënë mundësi për të qënë një barrierë ndaj shkeljeve ligjore dhe abuzimeve. Ankuesi thekson se ai nuk ka kundërshtuar, apo është ankuar ndaj urdhërave të Kryetarit të Bashkisë. Kundërshtimet e tij kanë qënë për urdhërat verbal ose shkresorë, individual ose në grup nga zv/kryetari, sepse bazuar në rregulloren e bashkisë, specialisti, merr pjesë në hartimin e projekt-preventivave sipas grupit të punës të ngritur nga Kryetari i Bashkisë. Pra, jemi në rastin e tejkalimit të kompetencave nga zv/kryetari, bazuar në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë 2018, Neni 13, pika 13.1, si dhe shkelje e detyrave të tija funksionale, pika 13, sipas po

<sup>3</sup> Referuar e-mail-it të dërguar në datë 30.12.2020.

kësaj rregulloreje. Diskriminimi nga ana e Bashkisë Berat ka vazhduar dhe më tej, në rastet kur ndaj tij është marrë masë disiplinore vërejtje. Në asnjë rast atij nuk i është dhënë e drejta për tu dëgjuar, mbrojtur apo parashtruar fakte dhe prova sipas parashikimit ligjor, pasi ai ka marrë dijeni për vërejtjen e vendosur vetëm në momentin që kjo vërejtje i ka ardhur zyrtarisht. Ankuesi informon se i është drejtuar tri herë me shkresë Kryetarit të Bashkisë për detyrat e ngarkuara në kundërshtim me ligjin dhe rregulloren e Brendshme të Bashkisë nga zv/kryetari, por nuk ka marrë përgjigje (shkresa nr. 2002/2, datë 06.05.2020, nr. 3493, datë 22.04.2020 dhe nr. 3493/1, datë 04.09.2020). Ankuesi shpjegon se duke nisur nga dita e largimit të ish-drejtorit të tij, deri në depozitim të ankesës së tretë, në datë 04.09.2020, është shmangur nga detyrat e tija funksionale. Urdhëri për përfshirjen e tij në Komisionin e Shpronësimeve ka dalë në datë 24.10.2019, me nr. 717, ndërsa detyrat konkrete për këtë komision kanë filluar disa muaj më vonë. Pra, për një periudhë relativisht të gjatë, është shmangur nga detyrat. Në rast se angazhimi në këtë komision, do justifikonte shmangien e tij nga detyrat, bën me dije se kjo s'ka ndodhur me asnjë anëtar tjetër komisioni (7 në total) dhe kjo është lehtësisht e vërtetueshme pasi drejtoria do kishte ndaluar së funksionuari, sepse 4 nga 6 punonjësit e drejtorisë janë anëtarë të Komisionit të Shpronësimeve (bashkangjitur Urdhëri nr. 717, datë 24.10.2019, Urdhëri nr. 764, datë 30.10.2020). Gjithashtu, ankuesi shprehet se nuk ka pasur asnjëherë ndonjë pretendim në lidhje me komisionin, fakt i cili vërtetohet, sepse në asnjë nga shkresat/ankesat drejtuar institucionit nuk shprehet lidhur me detyrat që i ngarkoheshin nga ky komision. Në rast se do të kishte konflikt, apo pretendim mbi detyrat e ngarkuara nga angazhimi në këtë komision, është i sigurt që zv/kryetari do e largonte nga komisioni, ashtu si ndodhi me Komisionin e Licencimit të Karburanteve nr. 666, datë 02.10.2019, ku e kanë larguar me Urdhërin nr. 10, datë 13.01.2020. Lidhur me pretendimin mbi mungesën e komunikimit me Kryetarin e Bashkisë, vërtetohet nëpërmjet moskthimit të përgjigjeve për asnjë nga shkresat e tija (bashkangjitur shkresa nr. 2002/2, datë 06.05.2020, nr. 3493, datë 22.04.2020 dhe nr. 3493/1, datë 04.09.2020). Moskomunikimi i tij me zv/kryetarin vërehet në procedurat e kthimit të përgjigjeve për shkresat e sigluara me emrin e tij. Kolegët e tjerë priten në zyrë për çdo diskutim, kurse komunikimi me të kryhet nëpërmjet zyrës së protokollit (bashkangjitur shkresa nr. 5483). Pretendimi i tij mbi refuzimin e lejes vjetore, si mënyrë hakmarrje në sajë të hapësirave të lejuara nga ligji, ngrihet mbi bazën e urdhërit të punës (bashkangjitur Urdhëri nr. 717, datë 24.10.2019, Urdhëri nr. 764 datë 30.10.2020, Shkresa nr. 5544 datë 17.11.2020). Në këtë urdhër, nuk përcaktohet asnjë afat. Mosmiratimi i lejes së zakonshme, pa një shkak ligjor, në kushtet kur mungesa e tij nuk do të krijonte asnjë pasojë institucionit, është sjellje diskriminuese nga Bashkia Berat. Në rastin e kërkesës për leje në rast vdekje, personalisht, ka dorëzuar kërkesën për leje në protokoll me nr. 3420, datë 24.08.2020, por gjithashtu ka komunikuar me email, datë 24.08.2020, zv/kryetarin, dhe me sms po atë datë, Sekretaren e Përgjithshme, A.T, nga të cilët nuk ka marrë përgjigje nga askush apo ti kërkohej dokument për ta vërtetuar (bashkangjitur kërkesa me nr. 3920, datë 24.08.2020, e-maili drejtuar zv/kryetarit). Ankuesi informon se nëse Bashkia Berat pretendon miratimin e statusit të nëpunësit civil në heshtje, atëherë duhet ti ishte njoftuar, ashtu si ishin njoftuar kolegët e tij”.



- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 144, datë 01.12.2020, Komisioneri me shkresën nr. 324, datë 18.02.2020 njoftoi palët për zhvillimin e një seance dëgjimore në datë 25.02.2021, duke kërkuar shpjegime dhe kopje të dokumenteve si më poshtë:
  - Kopje të të gjithë urdhrave të punës të lëshuar nga L.B dhe raporteve të dhëna nga ankuesi në përgjigje të detyrave të caktuara, nga muaji shkurt 2020 deri në datë 30.11.2020.
  - Kopje të plotë të procedurës së dhënies së masës disiplinore “Vërejtje”, të datës 05.05.2020, duke përfshirë, kopje të detyrave të pa realizuara në kohë nga ankuesi, kopje të procesverbalit të takimit, etj.
  - Kopje të relacionit të grupit të punës për shqyrtimin e ankesës për diskriminim në punë të G.GJ, në datat, 22.07.2020 dhe 04.09.2020.
  - Kopje të vendimit të emërimit të L.B në detyrën e zv/kryetarit të Bashkisë dhe të Drejtorit të Komanduar të Drejtorisë së Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve.
  - Kopje të vlerësimit të punës së ankuesit për vitet: 2018, 2019 dhe 2020.
  - Kopje të procesverbalit të takimit të zhvilluar në datë 07.10.2020, mes Kryetarit të Bashkisë, zv/kryetarit, L.B dhe ankuesit (nëse ka).
  - Kopje të përgjigjeve të dhëna nga ana e Bashkisë për lejen për rast vdekje të kërkuar nga ankuesi, nr. 3920 prot, datë 24.08.2020.
  - Informacion për emrat e punonjësve të Bashkisë Berat, të cilëve i është miratuar leja e kërkuar për raste vdekje të të afërmeve, për vitin 2020.
  - Kopje të përgjigjeve të dhëna ankuesit nga ana e Bashkisë për kryerjen e lejes vjetore të vitit 2020, të bëra në vazhdimësi, pas datës 13.11.2020.
  - Kopje të të gjitha akteve të konfirmimit të nëpunësit civil në Bashkinë Berat nga data 01.10.2019 deri në datë 30.06.2020.
  - Kopje të strukturës dhe organigramës së Bashkisë Berat, të miratuar me Vendimin nr. 120, datë 21.02.2020.
  - Kopje të përshkrimit të punës të të gjitha pozicioneve të punës në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, së bashku me emrat e punonjësve.

Seanca u zhvillua me praninë e palëve në proces: subjektit ankues, G.GJ dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësueses me autorizim<sup>4</sup> të Bashkisë Berat, znj. I. Ç.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

---

<sup>4</sup> Me shkresën, datë 22.02.2021.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti ankues i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në. Subjekti ankues, deklaroi<sup>5</sup> se fillimisht ka menduar se sjellja diskriminuese e zv/kryetarit të bashkisë ndaj tij ka qenë për shkak të karakterit të fortë të tij, por më vonë ka kuptuar se sjellja diskriminuese ka qenë për shkak të aktivitetit të tij politik, si anëtar i subjektit, Lëvizja Socialiste për Integrim. Gjithashtu, ankuesi ka shtuar<sup>6</sup> se i është komunikuar shkurtimi i vendit të punës për shkak se formimi i tij profesional nuk përkon me asnjë nga pozicionet e punës, por në dijeninë e tij ka dhe punonjës të tjerë që nuk i përkon pozicioni i punës me formimin profesional dhe vazhdojnë në punë.

Përfaqësuesja e Bashkisë Berat, lidhur me pretendimin për mosshqyrtimin e ankesës për diskriminim të bërë nga G.GJ, deklaroi<sup>7</sup> se, bashkia nuk ka shqyrtuar në thelb pretendimin e ankuesit por i ka kthyer përgjigje me shkrim për ankesën e bërë. Gjithashtu, përfaqësuesja e bashkisë, lidhur me përzgjedhjen e punonjësit që do qëndronte në punë pas ndryshimit të strukturës, deklaroi se, ndryshimi i strukturës së bashkisë solli dhe reduktimin e vendit të punës së ankuesit dhe duke qenë se kolegja e G.GJ kishte më shumë vite punë dhe për shkak të gjendjes familjare është bërë përzgjedhja e saj për të qëndruar në punë.

Në përfundim të seancës dëgjimore, nga ana e institucionit të Komisionerit u la si detyrë Bashkisë Berat që të dërgonte informacion dhe dokumentacionin e kërkuar për zhvillimin e seancës dëgjimore si dhe dokumentacionin e kërkuar gjatë seancës, lidhur me procedurën e ndryshimit të strukturës së Bashkisë Berat dhe kriteret e përzgjedhjes së punonjësve, ndërsa ankuesi do të dërgonte emrat e punonjësve që nuk plotësonin kriteret dhe kanë qëndruar në punë, në kuadër të pretendimit të ri të ankuesit për largim nga puna.

Subjekti ankues me e-mail-in datë 02.04.2021 ka dërguar të gjithë dokumentacionin e procedurës së largimit të tij nga puna dhe ka kërkuar që të shqyrtoheshin veprimet diskriminuese të Bashkisë Berat, lidhur me shkurtimin e vendit të punës dhe zgjidhjen e kontratës, në vijim edhe të pretendimit të ngritur gjatë seancës dëgjimore.

- Në mungesë të dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar me shkresën nr. 324, datë 18.02.2021, “Njoftim për seancë dëgjimore” dhe dokumentacionit të kërkuar gjatë seancës dëgjimore, lidhur me ristrukturimin e bashkisë, Komisioneri nëpërmjet shkresës me nr. 324/1, datë 06.04.2021, i është drejtuar sërish Bashkisë Berat, për dërgimin e dokumentacionit, si më poshtë:
  - Kopje të strukturës së Bashkisë Berat të miratuar me Vendimin nr. 827, datë 15.12.2020.
  - Kopje të përshkrimit të punës, kriterëve të përgjithshme e të veçanta dhe arsimit, në të gjitha pozicionet e punës në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, së bashku me emrat e punonjësve, sipas strukturës së vitit, 2020 dhe 2021.

<sup>5</sup> Referuar deklarimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore, min 11.

<sup>6</sup> Referuar deklarimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore, min 41.30.

<sup>7</sup> Referuar deklarimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore, min 24.40 dhe 35.30.

- Shpjegime dhe dokumentacion lidhur me përzgjedhjen e punonjësit që do vazhdonte marrëdhëniet e punës në pozicionin e specialistit për monitorimin e investimeve në drejtorinë sipërcituar.
- Kopje të dosjes së punonjëses, V.K.
- Shpjegime lidhur me mosplotësimin e kërkesës së bërë nga G.GJ, nr. 1204 prot, datë 26.02.2021, në të cilën kërkon ti vihet në dispozicion dosja e punonjësit.

Në vijim të procedurës, Bashkia Berat, me shkresën nr. 1913/1, datë 15.04.2021, protokolluar me tonën me nr. 324/2, datë 21.04.2021 ka dërguar dokumentacionin e kërkuar dhe në mes të tjerash ka informuar se: *“Nga eprori direkt i G.GJ ka dalë shkresa nr. 2002, datë 05.05.2020, me lëndë “Propozim për masë disiplinore vërejtje”. Lidhur me moskonfirmimin me shkrim të statusit të nëpunësit civil, bashkia informon se për asnjë prej punonjësve nuk është bërë konfirmimi deri në fund të vitit 2020. Në bazë të Vendimit nr. 224, datë 30.12.2020 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, janë marrë masat për rregullimin e situatës, pavarësisht se ankuesi është trajtuar gjatë gjithë kohës si nëpunës me status nëpunësi civil. Për ankuesin ka dalë shkresa nr. 69, datë 07.01.2021, “Konfirmim statusi të nëpunësit civil”. Lidhur me mosdhënien e lejes për rast vdekje, bashkia informon se, ankuesi pasi i është drejtuar për leje vdekje në mënyrë verbale, i është konfirmuar mosparaqitja në punë për një periudhë 1 javore, e cila vërtetohet me prezencat ditore të punonjësve datë 24.08.2020 deri më datë 28.08.2020, në të cilat ankuesi nuk ka firmosur, por ka marrë pagën e plotë, pavarësisht se nuk është paraqitur në punë. Për vitin 2020 në Bashkinë Berat nuk ka pasur asnjë rast për dhënie leje për vdekje. Lidhur me pretendimin për mosmarrjen e lejes vjetore, bashkia informon se asnjë punonjës i Drejtorisë së Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve për periudhën Tetor-Dhjetor 2020 (periudhë në të cilën ka kërkuar leje ankuesi) nuk ka përfutuar leje vjetore për shkak të intensitetit të detyrave dhe ngarkesës në këtë drejtori, por ankuesi e ka përfutuar shpërbimin për lejen e pakryer për vitin 2020. Lidhur me pretendimin dhe pyetjet e KMD-së, përsa i përket procedurave të ndjekura nga bashkia për përfundimin e marrëdhënieve të punës me ankuesin, bashkia sqaron se këto pretendime nuk janë pjesë e objektit të shqyrtimit të ankesës nr. 1669/1, datë 09.12.2020. Procedurat janë ndjekur sipas legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil nga ku ankuesi ka përfutuar të gjitha benefitet që i njej ligji. Lidhur me dokumentacionin e përzgjedhjes për vazhdimin e marrëdhënieve të punës, bashkia informon se në strukturimin e fundit të kryer nga Bashkia Berat, është shkurtuar vendi i punës së ankuesit, po ashtu specialistët e tjerë të drejtorisë ku punonte ankuesi kanë emërtesa të ndryshme nga ajo që mbante ankuesi në momentin e strukturimit dhe rrjedhimisht kriteret e vendeve të punës kanë qenë të ndryshme, si dhe nuk ka pasur vende vakante që ti përshtatej arsimimit të ankuesit në momentin e ristrukturimit. Dosja personale i është vënë në dispozicion ankuesit sipas legjislacionit në fuqi dhe në çdo kohë punonjësve të bashkisë nuk ju është privuar e drejta për të tërhequr dosjet e tyre personale në momentin e shpërndarjes së marrëdhënieve të punës”.*

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 dhe nenin 3/1, parashikojnë se: “*Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi*”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre*”.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: “*Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij*”.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i është ofruar mundësia që të japë shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga ankuesi.

#### **A. Lidhur me trajtimin e pafavorshëm të ankuesit nga ana e Bashkisë Berat.**

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit administrativ rezulton se ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune pranë Bashkisë Berat. Ankuesi me Urdhërin nr. 786, datë 27.09.2018 është emëruar në Shërbimin Civil në periudhë prove në pozicionin, Specialist i Kontrollit të Zhvillimit të Punëve Publike dhe Private, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Me Urdhërin nr. 185, datë 30.03.2020, G.GJ është emëruar sipas strukturës së re, të administratës të vitit 2020 në pozicionin, Specialist për Monitorimin e Investimeve, në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, pozicion të cilin e ka mbajtur deri në momentin e lirimit nga shërbimi civil.

Me Urdhërin nr. 573, datë 05.08.2019 “Për emërim nëpunësi në detyrë”, L.B është emëruar në pozicionin, Zëvendëskryetar i Bashkisë Berat, dhe me Urdhërin nr. 116, datë 19.02.2020 “Për komandim të përkohshëm detyre dhe përgjegjësie”, L.B krahas detyrës funksionale si

Zëvendëskryetar i bashkisë është komanduar dhe në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, duke filluar nga data 25.02.2020.

Me shkresën nr. 1066, datë 21.02.2020, “*Tërheqje vëmendje*”, drejtuar nëpunësit civil G.GJ, Kryetari i Bashkisë Berat ka tërhequr vëmendjen ankuesit, me motivacionin “*Vonesa në zbatim të detyrave të ngarkuara nga eprori*”.

Me shkresën nr. 2002, datë 05.05.2020, Drejtori i Komanduar, L.B, ka propozuar dhënien e masës disiplinore “*Vërejtje*” për punonjësin G.GJ me motivacionin: “*Për mos realizim në kohë të detyrave të ngarkuara*”.

Me Urdhërin nr. 260, datë 05.05.2020 “*Për dhënie masë disiplinore nëpunësit civil*”, Kryetari i Bashkisë ka urdhëruar që nëpunësit civil G.GJ, t’i jepej masa disiplinore “*Vërejtje*”, me motivacionin “*Për mos realizim në kohë të detyrave të ngarkuara*”.

Duke mos rënë dakord me dhënien e masës disiplinore, ankuesi me shkresën nr. 2002/2 prot, datë 06.05.2020, “*Kërkesë për rishikimin e masës me shkresë nr. 2002/1 “Dhënie mase disiplinore”*”, drejtuar Kryetarit të Bashkisë Berat, ka argumentuar situatën dhe marrëdhëniet e punës me Drejtorin e Komanduar dhe ka kërkuar: “*1- Të sqarohet qëllimi i sjelljes nga ana e zv/kryetarit. 2- Të argumentohet arsyeja mbi të cilën është dhënë masa disiplinore. 3- Të rishikohet masa e dhënë*”. Nga ana e bashkisë nuk ka një përgjigje për shkresën e ankuesit.

Ankuesi duke u ndjerë i anashkaluar në detyrat që duhet të mbulonte sipas pozicionit të tij, me shkresën nr. 3493, datë 22.07.2020, i është drejtuar përsëri Kryetarit të Bashkisë, të cilin e ka vënë në dijeni se po diskriminohet nga L.B, pasi shkresat siglohen vetëm në emrin e koleges që është në të njëjtin sektor dhe së fundmi siglimi i shkresave po i bëhej dhe një punonjëseje të sapa emëruar në sektorin e planifikimit, e cila nuk ka lidhje me detyrat e sektorit të investimeve. Në këtë shkresë ankuesi ka kërkuar nga Kryetari i Bashkisë, zgjidhjen e shqetësimit të ngritur në mënyrë të përsëritur. Nga ana e bashkisë nuk ka një përgjigje për shkresën e ankuesit.

Në vijim, ankuesi me Shkresën nr. 3493/1, datë 04.09.2020 “*Kërkesë ankimore*”, drejtuar Kryetarit të Bashkisë, ka rikërkuar marrjen e masave për ndërprerjen e gjendjes së paligjshmërisë, të diskriminimit dhe viktimizimit të tij, nga ana e zv/Kryetarit të Bashkisë, L.B. Në mes të tjerash, G.GJ në këtë shkresë ka sjellë në vëmendje të Kryetarit të Bashkisë, dhe mbrojtjen e punëmarrësit nga veprimet diskriminuese të punëdhënësit, bazuar në parashikimet ligjore të nenit 13 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, i cili në pikën 13/1/c parashikon se: “*Punëdhënësi është i detyruar: c) t’u përgjigjet efektivisht dhe në përputhje me këtë ligj ankimeve të marra për shkak të diskriminimit të kryer nga punëmarrësit e tij, brenda një muaji nga marrja e tyre*”.

Në përgjigje të ankesës për diskriminim të G.GJ, Bashkia Berat me shkresën nr. 3493/2, datë 01.10.2020, është përgjigjur se ankimi, bazuar në nenin 3<sup>8</sup> dhe 128<sup>9</sup> të Kodit të Procedurave

---

<sup>8</sup> 1. “*Akti administrativ*”: a) “*Akti administrativ individual*” është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e



Administrative, nuk pranohej për shkak se G.GJ nuk legjitimohej në ngritjen e ankimit dhe mjetet ligjore administrative nuk përfshinin objektin e ankimit të tij.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga palët, pas ankesës së bërë nga G.GJ për diskriminim, rezulton se G.GJ në mënyrë individuale dhe si pjesë e grupeve të punës, i janë ngarkuar disa detyra, sipas shkresave në vijim: Nr. 983, datë 20.10.2020; nr. 1037, datë 05.11.2020; nr. 1031, datë 03.11.2020; nr. 1030, datë 03.11.2020; nr. 1044, datë 06.11.2020; nr. 5325, datë 02.11.2020; nr. 1053, datë 09.11.2020; nr. 5158, datë 23.10.2020; nr. 5315, datë 30.10.2020; nr. 1050, datë 09.11.2020; nr. 1026, datë 03.11.2020; nr. 1113, datë 25.11.2020; nr. 4839, datë 07.10.2020; nr. 5214, datë 26.10.2020; nr. 5216, datë 26.10.2020; nr. 10181, datë 21.11.2019 (sigluar datë 20.10.2020) dhe nr. 6141, datë 24.12.2020.

Referuar korrespondencës (shkresore dhe elektronike) së shkëmbyer mes L.B, në cilësinë e Drejtorit të Komanduar, ankuesit dhe disa punonjësve të grupeve të punës, rezulton se për disa nga detyrat e ngarkuara ka pasur kundërshtime dhe prapësime, lidhur me mosmarrëveshjet dhe keqkuptimet që kanë pasur punonjësit e drejtorisë me detyrat e ngarkuara nga Drejtori i Komanduar, dhe në veçanti, problematikat e ngritura në shkresat: nr. 5339/1, datë 03.11.2020; nr. 5337/1, datë 03.11.2020; nr. 5315/1, datë 02.11.2020; nr. 5338/1, datë 03.11.2020; e-mail-in datë 09.11.2020 lidhur me detyrën e ngarkuar me shkresën nr. 5325, datë 02.11.2020; nr. 5483/1, datë 12.11.2020 dhe nr. 6141/1, datë 28.12.2020.

Subjekti ankues gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore dhe me e-mailin datë 02.04.2021 ka pretenduar se i është komunikuar shkurtimi i vendit të punës për shkak se formimi i tij profesional nuk përkon me asnjë nga pozicionet e punës, por në dijeninë e tij ka dhe punonjës të tjerë që nuk i përkon pozicioni i punës me formimin profesional dhe vazhdojnë të jenë në marrëdhënie pune.

- *Lidhur me pretendimin e Bashkisë Berat, se masat disiplinore të dhëna ankuesit, në datë 21.02.2020 dhe 05.05.2020, kanë qenë me motivacionin për mosrealizimin në kohë të detyrave të caktuara.*

---

*funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete; 11. “Veprim tjetër administrativ” është çdo formë e njëanshme e veprimtarisë së organit publik në ushtrimin e funksioneve të tij publike, që nuk plotëson kriteret për të qenë akt administrativ apo kontratë administrative dhe që sjell pasojë juridike për të drejtat subjektive dhe interesat legjitimë.*

<sup>9</sup>128. *Legjitimimi dhe mjetet e ligjore administrative; 1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj të ligjshëm cenohen nga ky veprim apo mosveprim. 2. Përveç kur parashikohet ndryshe nga ligji, mjetet ligjore administrative mund të ushtrohen për shkak të paligjshmërisë. 3. Mjetet ligjore administrative janë: a) ankimi administrativ, i cili përfshin: i) Ankimin administrativ ndaj aktit administrativ ose mosveprimit të organit publik për nxjerrjen e aktit të brenda afatit të parashikuar dhe/ose veprimit procedural të organit publik gjatë procedurës administrative (Ankimi administrativ ndaj aktit administrativ); ose ii) kundërshtimi administrativ ndaj një veprimi tjetër administrativ nën regjimin e së drejtës administrative (Kundërshtimi administrativ); b) rishikimi. 4. Pala nuk ka të drejtë të ushtrojë për së dyti mjetet ligjore administrative për të njëjtën çështje.*

Nga faktet dhe provat e administruara, arsyeja e pretenduar për dhënien e masës disiplinore për mosrealizim në kohë të detyrave nga ana e G.GJ, rezulton e provuar vetëm me deklarin verbal të bërë nga Bashkia Berat. Referuar dokumentacionit të dorëzuar, rezulton se për masën, tërheqje vëmendje, datë 21.02.2020, me motivacionin “*Vonesa në zbatim të detyrave të ngarkuara nga eprori*”, të dhënë nga Kryetari i Bashkisë, nuk rezulton asnjë shkresë që të vërtetojë këtë fakt, për më tepër që në atë datë, L.B nuk ka qenë i komanduar në detyrën e drejtorit (ka filluar detyrën në datë 25.02.2020) dhe nga ana e ish drejtorit të drejtorisë nuk rezulton se ka pasur propozim për masë disiplinore për ankuesin.

Bashkia Berat nuk provoi edhe pse iu kërkua në mënyrë të përsëritur që të tregonte se cilat ishin detyrat dhe punët të cilat ankuesi nuk kishte realizuar në kohë apo në cilësinë e kërkuar, deri në datë 05.05.2020. Fakti që nuk rezulton asnjë shkresë në të cilin të faktohet se ankuesi nuk ka kryer detyrat në kohë apo që të ketë refuzuar/kundërshtuar realizimin e tyre, ngarkon me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë dhe Drejtorin e Komanduar, për të provuar të kundërtën. Ankuesi me shkresën nr. 2002/2, datë 06.05.2020, ka kërkuar rishikimin e masës disiplinore, duke argumentuar se ka kryer të gjitha detyrat e ngarkuara, por ka pasur kundërshtime personale të L.B. Duke pasur barrën e provës për të provuar arsyen e dhënies së masës disiplinore, Kryetari i Bashkisë dhe Drejtori i Komanduar, në cilësinë e punëdhënësit nuk arritën të provojnë shkeljen/et e bëra nga ana e ankuesit, për të legjitimuar në këtë mënyrë faktin se dhënia e masës disiplinore ka të bëjë me mosrealizimin në kohë të detyrave.

Referuar dosjes personale të punonjësit G.GJ dhe mbështetur në provat dhe informacionin e administruar nga palët në proces, nuk evidentohet asnjë fakt, se ndaj ankuesit të jenë dhënë masa disiplinore, vlerësime pune negative apo mosmarrëveshje me drejtuesit e mëparshëm. Kjo situatë e krijuar ka nisur në momentin që L.B është emëruar në pozicionin e zv/Kryetarit të bashkisë dhe më pas si Drejtor i Komanduar i Drejtorisë së Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve.

Nga ana e Kryetarit të Bashkisë dhe Drejtorit të Komanduar nuk u sollën prova dhe argumentime bindëse që të mund të provonin apo përlligjin faktin se dhënia e masave disiplinore, të kishte ardhur për arsye të ligjshme dhe të ishte e justifikuar.

Marrëdhëniet e punës së ankuesit, si nëpunës civil, janë rregulluar nga dispozitat e Ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, dhe nga aktet nënligjore në zbatim të tij.

Në nenin 59 të Ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, parashikohen kompetencat dhe procedura për masat disiplinore. Në pikën 1 të këtij neni parashikohet se: “*Masa disiplinore e parashikuar në shkronjën “a”<sup>10</sup> të nenit 58 të këtij ligji, merret nga eprori direkt. Eprori direkt detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen me faj të detyrimeve nga nëpunësi civil*”.

---

<sup>10</sup> a) vërejtje;

Në pikën 1 të Kreut II të VKM-së nr. 115, datë 05.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, parashikohet se: “1. Me “procedurë disiplinore” do të kuptohet gjithë veprimtaria administrative, që kryhet që nga momenti i konstatimit të një shkelje disiplinore, vënies në dijeni, me shkrim, të personit që pretendohet se ka kryer shkeljen, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga organi disiplinor”.

Në analizë të legjislacionit sipërcituar dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga palët, rezulton se ankuesi nuk është vënë në dijeni nga ana e Drejtorit të Komanduar, që në këtë rast ka vepruar në cilësinë si epror direkt, për fillimin e procedurës disiplinore në ngarkim të tij. Ankuesi rezulton se ka marrë dijeni për masën disiplinore, në momentin kur është njohur me Urdhërin nr. 260, datë 05.05.2020 “Për dhënie masë disiplinore nëpunësit civil”, “Vërejtje”, me motivacionin “Për mos realizimin në kohë të detyrave të ngarkuara”.

Për sa më sipër, Komisioneri ka konstatuar se nuk ekziston asnjë praktikë për procedim disiplinor të G.GJ, nga ana e drejtuesve të Bashkisë Berat, përveç propozimit dhe Urdhërit të sipërpërmendur. Ankuesi nuk është njoftuar lidhur me procedimin disiplinor në ngarkim të tij, nuk i është kërkuar zyrtarisht për të dorëzuar observacionet përkatëse, si dhe nuk ekziston asnjë akt që të vërtetojë motivacionin: “Për mos realizimin në kohë të detyrave të ngarkuara”.

Kryetari i Bashkisë dhe Drejtori i Komanduar kanë vepruar në shkelje të nenit 59/7, të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, ku parashikohet se: “Procedimi administrativ disiplinor garanton të drejtën e nëpunësit për t’u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, për t’u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, të drejtën për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova, për mbrojtje juridike dhe të drejtën për t’u asistuar, si dhe të drejtën për t’u ankuar ndaj vendimit përfundimtar.....”.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se ankuesi është cënuar në të drejtën e tij për një proces të rregullt, pasi ai nuk ka pasur në mënyrë efektive të ushtrijë të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur në lidhje me arsyet e dhënies së masës disiplinore në marrëdhëniet e punës. Për këtë arsye, Komisioneri vlerëson se ankuesi është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Kryetarit të Bashkisë, E.D dhe Drejtorit të Komanduar, L.B.

- Lidhur me mosmarrjen në shqyrtim të kërkesave dhe ankesave për diskriminim të bëra nga ankuesi.

Referuar masave disiplinore të dhëna nga Kryetari i Bashkisë dhe Drejtori i Komanduar, për ankuesin dhe kronologjisë së ngarjeve, konstatohet se marrëdhëniet e punës mes drejtorit të komanduar dhe ankuesit, nuk kanë qenë të një bashkëpunimi të ndërsjelltë, pasi brenda një periudhe të shkurtër (nga data 06.05.2020 deri në datë 04.09.2020), kanë pasur mosmarrëveshje lidhur me marrëdhëniet e punës dhe ankuesi i është drejtuar me tre shkresa Kryetarit të Bashkisë, duke e vënë në dijeni dhe duke kërkuar që të merren masa për veprimet personale dhe diskriminuese të bëra nga L.B në drejtim të tij. Kështu:

- Ankuesi me shkresën nr. 2002/2 prot, datë 06.05.2020, “*Kërkesë për rishikimin e masës me shkresë nr. 2002/1 “Dhënie mase disiplinore”*”, drejtuar Kryetarit të Bashkisë Berat, ka përshkruar situatën dhe marrëdhëniet e punës me Drejtorin e Komanduar dhe ka kërkuar: “*1- Të sqarohet qëllimi i sjelljes nga ana e zv/kryetarit. 2- Të argumentohet arsyeja mbi të cilën është dhënë masa disiplinore. 3- Të rishikohet masa e dhënë”*”.
- Ankuesi duke u ndjerë i anashkaluar në detyrat që duhet të mbulonte sipas pozicionit të tij, me Shkresën nr. 3493, datë 22.07.2020, i është drejtuar përsëri Kryetarit të Bashkisë, të cilin e ka vënë në dijeni se po diskriminohet nga L.B.
- Në vijim, ankuesi me Shkresën nr. 3493/1, datë 04.09.2020 “*Kërkesë ankimore*”, drejtuar Kryetarit të Bashkisë, ka rikërkuar marrjen e masave për ndërprejen e gjendjes së paligjshmërisë, të diskriminimit dhe viktimizimit të tij, nga ana e zv/Kryetarit të Bashkisë, L.B.

Në përgjigje të shkresës nr. 3493/1, datë 04.09.2020 “*Kërkesë ankimore*”, ankuesit i kthehet përgjigje, nëpërmjet shkresës nr. 3493/2, datë 01.10.2020, të Kryetarit të Bashkisë Berat, në të cilën nuk jepet asnjë sqarim mbi pretendimet për diskriminim të ankuesit, por i citohet se, bazuar në nenin 3 dhe 128 të Kodit të Procedurave Administrative, G.GJ nuk legjitimohej në ngritjen e ankimit dhe mjetet ligjore administrative nuk përfshinin objektin e ankimit të tij. Në këtë kontekst, Komisioneri konstaton se çështja e diskriminimit e pretenduar nga ankuesi, në mënyrë të përsëritur nuk është shqyrtuar nga Kryetari i Bashkisë, në kundërshtim me parashikimin e nenit 5/1 dhe nenin 13/1/c, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, në të cilin përcaktohet se: “*5/1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë*”, ndërsa në nenin 13/1/c përcaktohet se: “*1. Punëdhënësi është i detyruar: c) t’u përgjigjet efektivisht dhe në përputhje me këtë ligj ankimeve të marra për shkak të diskriminimit të kryer nga punëmarrësit e tij, brenda një muaji nga marrja e tyre*”.

Në nenin 5 të Ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, parashikohen parimet e administrimit të shërbimit civil. Në këtë nen përcaktohet se: “*Administrimi i shërbimit civil udhëhiqet nga ligji dhe bazohet në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, si dhe garanton qëndrueshmërinë në detyrë të nëpunësit civil dhe vazhdimësinë e shërbimit civil*”. Bazuar mbi parimin e mosdiskriminimit, Bashkia Berat duhet të kishte marrë masat për të trajtuar me seriozitet dhe paanshmëri pretendimet e ngritura në vijimësi nga ana e G.GJ.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se nga ana e Kryetarit të Bashkisë Berat nuk është bërë një analizë e thelluar dhe e plotë, për të nxjerrë arsyet dhe përgjegjësitë mbi pretendimet për diskriminim të subjektit ankues dhe të merreshin masa për trajtimin e padrejtë dhe të pabarabartë të Drejtorit të Komanduar kundër G.GJ.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se Kryetari i Bashkisë Berat, ka përgjegjësinë institucionale për marrjen e masave të nevojshme, për mbrojtjen e punëmarrësve nga diskriminimi dhe viktimizimi në marrëdhëniet e punësimit.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se ankuesi është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Kryetarit të Bashkisë Berat.

- *Lidhur me moskonfirmimin e statusit të nëpunësit civil të ankuesit nga ana e Bashkisë Berat.*

Subjekti ankues me Shkresën nr. 1471, datë 11.03.2020, drejtuar Kryetarit të Bashkisë, ka kërkuar konfirmimin e statusit të nëpunësit civil.

Në përgjigje të kërkesës së Komisionerit lidhur me pretendimin e ankuesit, Bashkia Berat informoi se: *“Në zbatim të ligjit “Për nëpunësin civil”, me përmbushjen e afateve ligjore punonjësi fiton automatikisht statusin e nëpunësit civil dhe se deri në fund të vitit 2020 nuk është konfirmuar asnjë punonjës që ka përmbushur afatin 1 vjeçar”.*

Gjatë trajtimit të ankesës nr. 45, datë 26.03.2021 të bërë nga A.P kundër Bashkisë Berat, Komisioneri është vënë në dijeni të shkresës nr. 4346, datë 07.07.2016, me lëndë: *“Konfirmim i aktit të Deklarimit të Statusit të Punësimit”*, me anë të së cilës është bërë konfirmimi i A.P si nëpunës civil, nga ana e administratës së mëparshme të Bashkisë Berat.

Në nenin 24/3 të ligjit 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“3. Në fund të periudhës së provës, institucioni, ku nëpunësi është i emëruar, vendos: a) konfirmimin e nëpunësit; b) zgjatjen e periudhës së provës një herë të vetme, deri në 6 muaj të tjerë, nëse për arsye të justifikuar ka qenë i pamundur vlerësimi i plotë i nëpunësit; c) moskonfirmimin e nëpunësit”.*

Në VKM-në nr. 243, datë 18.03.2015 *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, të ndryshuar, Kreu VI, pika 7, përcaktohet se: *“Bazuar në vlerësimet sipas pikës 6, të kreut VI, të këtij vendimi, dhe pas marrjes së mendimit me shkrim nga nëpunësi civil më i vjetër, i përcaktuar sipas pikave 3, 4 e 5, të kreut VI, të këtij vendimi, eprori direkt është i detyruar të vendosë: a) konfirmimin e nëpunësit civil, nëse ka përfunduar me sukses trajnimin e detyrueshëm në ASPA dhe është vlerësuar të paktën “kënaqshëm”; b) zgjatjen një herë të vetme deri në 6 (gjashtë) muaj të periudhës së provës, në rast të mospërfundimit me sukses të trajnimit të detyrueshëm në ASPA, pamundësisë së vlerësimit të plotë të nëpunësit, në rast se eprorit i nevojitet më shumë kohë për të vlerësuar nëpunësin, në rastet e mungesës në detyrë të nëpunësit për shkak të trajnimit afatgjatë, raportit mjekësor afatgjatë dhe në raste të tjera, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, të cilat rregullojnë mungesën në detyrë të nëpunësit; c) moskonfirmimin e nëpunësit civil. Në këtë rast nëpunësi lirohet nga shërbimi civil”,* ndërsa në pikën 8, parashikohet se: *“Mosrealizimi i procedurës së përcaktuar në pikën 7, të kreut VI, të këtij vendimi, brenda një afati 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike, konsiderohet “mospërmbushje detyre” nga eprori direkt”.*



Lidhur me sa më sipër, rezulton se Bashkia Berat, ka pasur raste të mëparshme kur strukturat e saj kanë bërë konfirmimin e nëpunësve civil, dhe në rastin e G.GJ ka pasur të gjithë mundësinë që pas kërkesës së ankuesit në datë 11.03.2020, Drejtori i Komanduar dhe Kryetari i Bashkisë, të ndërmerrnin veprimet e duhura sipas legjislacionit të sipërpërmendur, për konfirmimin e statusit të nëpunësit civil, për G.GJ.

Lidhur me këtë pretendim të ankuesit, Komisioneri vlerëson se bazuar në legjislacionin sipërcituar, Kryetari i Bashkisë dhe Drejtori i Komanduar janë në shkelje të parashikimit ligjor mbi konfirmimin e G.GJ me statusin e nëpunësit civil.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se ankuesi është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Kryetarit të Bashkisë Berat, E.D dhe Drejtorit të Komanduar, L.B.

- *Lidhur me pretendimin për kryerjen e orëve shtesë, mosdhënien e pushimit vjetor dhe mosdhënien e pushimit në rastin e vdekjes.*

Referuar formularit të ankesës, G.GJ ka informuar se në muajin Korrik 2020 ka shfrytëzuar një pjesë së lejes së zakonshme, pasi ishte planifikuar për të gjithë punonjësit e drejtorisë.

Me shkresat nr. 5539, datë 13.11.2020 dhe nr. 230, datë 15.01.2021, ankuesi ka kërkuar që të shfrytëzojë lejen vjetore prej një jave.

Lidhur me këtë pretendim, Bashkia Berat ka informuar se, asnjë punonjës i Drejtorisë së Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve për periudhën Tetor-Dhjetor 2020, nuk ka përfituar leje vjetore për shkak të intensitetit të detyrave dhe ngarkesës në këtë drejtori, por ankuesi është shpërblyer për pushimin vjetor të pa konsumuar.

Në VKM-në nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, në Kreun I, pika 5, përcaktohet se: “Me kërkesë të eprorit të drejtpërdrejtë dhe me miratimin e drejtuesit të institucionit përkatës, nëpunësit civil apo punonjësit mund t’i kërkohej të kryejë orë shtesë.....”. Në Kreun II, pika 2, përcaktohet se: “Kohëzgjatja e pushimit vjetor të paguar është 4 javë kalendarike. Koha e kryerjes së lejes së pushimit vjetor përcaktohet nga drejtuesi i institucionit, sipas kërkesës së nëpunësit civil apo të punonjësit, duke mos cënuar vijueshmërinë e punës.....”, ndërsa në pikën 9 përcaktohet se: “Nëpunësi civil apo punonjësi ka të drejtën e pushimit të paguar edhe për rastet si më poshtë vijon: ç. Vdekjen e prindërve, të gjyshërve, të bashkëshortit, të fëmijës, të vëllezërve, të motrave, 5 ditë”.

Në Formularin e Përshkrimit të Punës së specialistit, G.GJ, në rubrikën nr. XI. Kushtet e punës, përcaktohet se: “.... Me qëllim arritjen e afateve kohore, mund t’i kërkohej të punojë jashtë orarit zyrtar të punës, të shtunave, të dielave dhe në ditë pushimi zyrtare”. Ky formular është firmosur nga G.GJ, Drejtori S.DH dhe Sekretari i Përgjithshëm E.Z.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri vlerëson se është në tagrin e punëdhënësit, në këtë rast të Drejtorit të Komanduar, që në varësi të planifikimit dhe ngarkesës në punë, t'i kërkojë punëmarrësit, kryerjen e orëve jashtë orarit ose dhënien e pushimit vjetor në një kohë të përshtatshme për të dyja palët.

Lidhur me kërkesën për kryerjen e pushimit për rast vdekje, rezulton se ankuesi me shkresën nr. 3920, datë 24.08.2020 dhe e-mail-in datë 24.08.2020, drejtuar L.B, ka kërkuar leje 5 ditë, pasi i kishte vdekur gjyshja.

Referuar dokumentacionit të dërguar nga Bashkia Berat, rezulton se në dokumentet e prezencës ditore për datat 24-28.08.2020, G.GJ nuk është paraqitur në punë. Referuar Librit të pagës për vitin 2020, rezulton se G.GJ për periudhën e muajit gusht 2020, është paguar për 19 ditë punë dhe 3 ditë me raport mjekësor, pra nga ana e bashkisë pavarësisht se nuk i është kryer përgjigje për miratimin apo jo të lejes për rast vdekje, paga dhe për ditët e munguara për atë rast i janë paguar të plota.

Në lidhje me këtë pretendim, Komisioneri vlerëson se nuk u arrit të provohet që ankuesi është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Kryetarit të Bashkisë dhe Drejtorit të Komanduar.

Referuar sa më lart, në analizë të legjislacionit sipërcituar, Komisioneri vlerëson se, procedura e ndjekur për dhënien e masave disiplinore, mostrajtimin të ankesës për diskriminim dhe moskonfirmimi i statusit të nëpunësit civil të G.GJ, nga ana e Kryetarit të Bashkisë Berat, E.D dhe Drejtorit të Komanduar, L.B, është haptazi në shkelje të dispozitave ligjore<sup>11</sup> që rregullojnë e normojnë marrëdhëniet e punës: punëmarrës-punëdhënës.

**Për sa më lart, Komisioneri arrin në përfundimin se, subjekti ankues në cilësinë e punëmarrësit, është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme gjatë procedurës së dhënies së masës disiplinore, trajtimin të ankesave për diskriminim dhe moskonfirmimit të statusit të nëpunësit civil, nga ana e Drejtorit të Komanduar, L.B dhe Kryetarit të Bashkisë Berat, E.D, në cilësinë e punëdhënësit.**

**B. Lidhur me trajtimin e pafavorshëm të ankuesit nga ana e Bashkisë Berat gjatë procedurës së përfundimit të marrëdhënieve të punës në shërbimin civil.**

*Referuar dokumentacionit të administruar<sup>12</sup> gjatë procesit të hetimit, rezulton se:*

Ankuesi me Urdhërin nr. 786, datë 27.09.2018 është emëruar në Shërbimin Civil në periudhë prove në pozicionin, Specialist i Kontrollit të Zhvillimit të Punëve Publike dhe Private, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Me Urdhërin nr. 185, datë 30.03.2020, G.GJ është emëruar sipas strukturës së re, të administratës të vitit 2020 në pozicionin, Specialist për

<sup>11</sup> Shih fq 15-18 të Vendimit.

<sup>12</sup> Dokumentacionit të administruar gjatë trajtimit të ankesave: nr. 45, datë 26.03.2021 të A.P, nr. 157, datë 24.12.2020 të S.P, nr. 160, datë 29.12.2020 të D.H dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ankuesi.

Monitorimin e Investimeve, në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve.

Me Vendimin nr. 827, datë 15.12.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organigramës së bashkisë dhe të njëjve shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat për vitin 2021”, Kryetari i Bashkisë Berat ka miratuar strukturën organike të re.

Ndryshimet e pësuar në strukturë prekën edhe pozicionet e punës së Drejtorisë së Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve. Numri i punonjësve të drejtorisë nga 11 u reduktua në 9 dhe dy funksione pjesë e shërbimit civil: 1 pozicion Specialist për Monitorimin e Investimeve (G.GJ) dhe 1 pozicion Specialist i Menaxhimit të Mjedisit, që ishin më parë, me strukturën e re nuk ekzistonin më.

Në zbatim të vendimit të sipërcituar për të realizuar procesin e ristrukturimit të bashkisë, Njësia Përgjegjëse me shkresën nr. 248, datë 15.01.2021, ka ngritur Komisionin e Ristrukturimit, të përbërë nga tre anëtarë.

Më poshtë pasqyrohet si ka ndryshuar Struktura e Drejtorisë së Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve:

Drejtoria, sipas strukturës, datë 21.02.2020, gjithsej 11 punonjës.	Nr.	Drejtoria, sipas strukturës, datë 15.12.2020, gjithsej 9 punonjës.	Nr.
Drejtor	1	Drejtor	1
Specialist i kadastrës	1	Specialist i kadastrës	1
<b>Specialist për monitorimin e investimeve</b>	<b>1</b>		
Specialist për monitorimin e investimeve dhe regjistrin elektronik	1	Specialist për monitorimin e investimeve dhe regjistrin elektronik	1
Specialist për planifikimin e territorit dhe regjistrin elektronik	1	Specialist për planifikimin e territorit dhe regjistrin elektronik	1
Specialist i sistemit GIS	1	Specialist i sistemit GIS	1
Specialist projektimesh dhe regjistrin elektronik	2	Specialist projektimesh dhe regjistrin elektronik	2
<b>Specialist i Menaxhimit të Mjedisit</b>	<b>1</b>		
Topograf	2	Topograf	2
<b>TOTALI</b>	<b>11</b>		<b>9</b>

Përsa më sipër, pas propozimeve të Komisionit të Ristrukturimit, nga ana e Kryetarit të Bashkisë Berat, filloi procedura për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me G.GJ.

Referuar Procesverbalit nr. 275/1, datë 20.01.2021, Komisioni i Ristrukturimit pasi krahasoi strukturën e re me strukturën ekzistuese, pozicionet e punës që shkurtoheshin, përshkrimet e punës, dosjet e punonjësve që prekeshin nga shkurtime, mundësinë e transferimeve të punonjësve në pozicione të përafërta, vendosi përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të Nëpunësit Civil G.GJ nga pozicioni i punës Specialist për Monitorimin e Investimeve.

Në këtë kuptim, Bashkia Berat me shkresën nr. 245, datë 18.01.2021, ka njoftuar ankuesin për fillimin e procedurës së transferimit ose përfundimit të marrëdhënieve të punës në shërbimin civil, për shkak të ristrukturimit të institucionit. Komisioni i Ristrukturimit të Bashkisë Berat me Vendimit nr. 275/2. prot, datë 20.01.2021 vendosi përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësit civil G.GJ, pasi bazuar në Vendimin nr. 827, datë 15.12.2020 *“Për miratimin e strukturës, Organigramës së Administratës së Bashkisë dhe të Njësive Shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat”*, për vitin 2021, i është suprimuar pozicioni i punës nga ristrukturimi dhe nuk ka pozicion të lirë në shërbimin civil, në të cilin ky nëpunës civil, plotëson kushtet dhe kriteret për tu transferuar.

Me shkresën nr. 275/3, datë 26.01.2021, Bashkia Berat ka njoftuar G.GJ për Vendimin e Komisionit të Ristrukturimit.

Me Urdhërin nr. 107, datë 18.02.2021 *“Për ndërprerje të marrëdhënieve financiare nëpunësit civil”* është urdhëruar ndërprerja e marrëdhënieve të punës nga detyra në shërbimin civil të nëpunësit civil G.GJ, Specialist për Monitorimin e Investimeve në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, me motivacionin *“Ristrukturim i Strukturës së Administratës dhe shkurtim i vendit të punës”*.

Referuar strukturës organizative të mëparshme (datë 21.02.2020) të Drejtorisë së Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, vërtetohet se kjo drejtori përbëhej nga 11 punonjës, dhe G.GJ mbulonte detyrën e Specialistit të Monitorimit të Investimeve.

Referuar strukturës organizative të re (datë 15.12.2020) të Drejtorisë së Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, vërtetohet se kjo njësi përbëhet nga 9 punonjës, dhe dy pozicione të Specialistit të Monitorimit të Investimeve dhe Specialistit të Menaxhimit të Mjedisit, nuk figurojnë në këtë strukturë.

Referuar Procesverbalit nr. 275/1, datë 20.01.2021, Komisioni i Ristrukturimit, ka vlerësuar se punonjësi G.GJ nuk ishte në kushtet e transferimit të përhershëm apo të përkohshëm, pasi nuk kishte pozicione të lira në shërbimin civil që përputheshin me arsimimin/edukimin/përshkrimin e punës së kërkuar me atë të nëpunësit civil që i suprimohej pozicioni i punës. Ankuesi lidhur me pretendimin e ngritur gjatë seancës dëgjimore, nuk vuri në dispozicion të Komisionerit, emrat e punonjësve që nuk plotësonin kriteret dhe që kishin qëndruar në punë.

Për sa më sipër, Komisioneri nuk ka tagër të gjykojë mbi nevojat apo procesin e ristrukturimit të një institucioni si Bashkia Berat, por mbështetur në atributet që i jep ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mund të kryejë konstatim, nëse ankuesi i është nënshtruar apo ekspozuar një qëndrimi disfavorizues apo të pabarabartë, nga ana e Bashkisë Berat, në krahasim me punonjës të tjerë që ndodhen në kushte të njëjta apo të ngjashme me të, në kuptim të nenit 7, pika 1 të këtij ligji.

Mbështetur në analizimin e fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri vlerëson se nuk ndodhemi në kushtet e trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm të ankuesit, nga ana e Bashkisë Berat.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se për sa i përket ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, G.GJ nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Bashkisë Berat. Në mungesë të këtij trajtimi nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkakun e pretenduar nga ankuesi.

### **C. Shkaku i mbrojtur.**

Neni 1, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, i cili përcakton objektin e këtij ligji, shprehet se ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh. Ky nen parashikon një sërë shkaqesh, por ndërkohë përcakton se lista e shkaqeve të mbrojtura mbetet e hapur.

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1 si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ligji ka bërë në nenin 3, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakun të mbrojtur jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Ankuesi ka pretenduar se i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm për shkak të “*bindjeve politike*” pasi ai është aktivist dhe anëtar i Partisë “Lëvizja Socialiste për Integrim”, bindje këto të kundërta me titullarin e institucionit të Bashkisë Berat, i cili është zgjedhur kryetar bashkie si përfaqësues i Partisë Socialiste të Shqipërisë.

Referuar nenit 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, shkakun i bindjeve politike, i pretenduar nga ankuesi, konsiderohet si shkak i mbrojtur dhe diferencat në trajtim bazuar në këtë shkak janë të ndaluara dhe të mbrojtura nga ligji.

Në mbështetje të pretendimit të tij ankuesi ka paraqitur kartën e anëtarësimit në partinë, Lëvizja Socialiste për Integrim, datë 16.01.2017, Konfirmim e Anëtarësisë në këtë subjekt, datë 03.09.2020, si dhe se është aktivizuar publikisht në veprimtaritë politike të LSI-së dhe ka qenë vëzhgues në zgjedhjet e vitit 2017.

Në zgjedhjet vendore të datës 30.06.2019, Kryetar i Bashkisë Berat u zgjodh E.D, mbështetur nga subjekti politik, Partia Socialiste e Shqipërisë.

Rezulton gjithashtu se, L.B, me detyrë zv/Kryetar i Bashkisë Berat ka qenë kandidat për anëtarë i Këshillit Bashkiak Berat për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019 në Qarkun Berat, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

Kodi i Procedurës Administrative, në nenin 80, pika 3, të tij ka përcaktuar se: “*Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme*”.



Sa më sipër, Komisioneri vlerëson të provuar shkakun e pretenduar të diskriminimit, atë të “bindjeve politike” të kundërta me Kryetarin dhe zv/Kryetarin e Bashkisë Berat.

#### **D. Lidhja e trajtimit të padrejtë më pak të favorshëm me shkakun e mbrojtur.**

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, përse i takon dhënies së masës disiplinore, mosshqyrtimit të ankesës së tij për diskriminim dhe moskonfirmimit të statusit të nëpunësit civil.

**Nga Kryetari i Bashkisë Berat dhe Drejtori i Komanduar nuk u sollën prova dhe argumentime bindëse që të mund të provonin apo përlligjin faktin se dhënia e masës disiplinore, mostrajtimi i ankesave për diskriminim dhe moskonfirmimi i statusit të nëpunësit civil të ankuesit kanë ardhur për arsye të ligjshme.**

Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit lidhur me këtë shkak, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me këtë fakt.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit “*Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional*”. Dispozita kushtetuese i garanton çdo personi të drejtën për punë.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), nuk parashikon të drejtën për punë si një të drejtë të veçantë, por çështjet e punës trajtohen nga GJEDNJ-ja si çështje që hyjnë në sferën e veprimit të nenit 8, “*E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare*”. Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin për shkak të bindjeve politike, në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të. Ndërkohë Protokollin 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

E drejta për punë dhe mbrojtja nga diskriminimi në gëzimin e kësaj të drejte parashikohet edhe në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria të tilla si:

*Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore*<sup>13</sup>, i cili sanksionon të drejtën për punë në nenin 6. E drejta për punë e garantuar në këtë nen vendos detyrimin për të garantuar të drejtën për të mos u privuar nga puna në mënyrë të padrejtë<sup>14</sup>. Sipas nenit 2/2, të

<sup>13</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 7511 datë 08.08.1991

<sup>14</sup> Komenti i Përgjithshëm Nr.8, Komiteti për të Drejtat Sociale Ekonomike dhe Kulturore, paragrafi 4.

Paktit, të drejtat e parashikuara në këtë Pakt duhet të garantohen pa asnjë diskriminim bazuar ndër të tjera në bindjet politike të personit.

Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës<sup>15</sup> “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në fushën e punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi. Konventa e përkufizon diskriminimin si çdo dallim, përjashtim ose favorizim i bërë në baza të caktuara i cili ka efektin e zhdukjes në barazi dhe mundësi ose trajnim në punësim dhe profesion. Në kuptim të kësaj Konvente termi “diskriminim” përfshin: a) çdo dallim, përjashtim ose preferencë që bazohet në racën, ngjyrën, seksin, fenë, opinionin politik, prejardhjen kombëtare ose origjinën sociale, që ka për efekt të prishë ose të shtrembërojë barazinë e mundësive ose të trajtimit në fushën e punësimit ose të profesionit, b) çdo dallim tjetër, përjashtim ose preferencë që çon në prishjen apo shtrembërimin e barazisë, të mundësisë ose trajtimit në drejtim të punësimit ose profesionit, që mund të specifikohet nga një anëtar i interesuar, pasi të ketë konsultuar organizatat përfaqësuese të punëdhënësve dhe të punonjësve, si dhe organizma të tjerë të përshtatshëm.

*Karta Sociale Europiane*<sup>16</sup> në nenin 1, pika 2, parashikon: “*Me synimin që të sigurohet ushtrimi efektiv i së drejtës për punë, Palët angazhohen.....2 të mbrojnë efektivisht të drejtën e punëtorit për të fituar jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht...*” Ky parashikim, është interpretuar vazhdimisht nga Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale (KEDS) si vendosje e një të drejte për të mos u diskriminuar në punësim<sup>17</sup>. Garancitë për mbrojtjen nga diskriminimi parashikohen në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Europiane, ku përcaktohet shprehimisht mbrojtja nga diskriminimi për shkak të bindjeve politike.

Ligji 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimin. E në fakt mosdiskriminimi dhe parimi i barazisë janë të ndërthurura ngushtë. Parimi i barazisë kërkon që situata të barabarta trajtohen në mënyrë të barabartë dhe situata të jo të barabarta të mënyrë të ndryshme. Dështimi për ta bërë këtë konsiderohet diskriminim, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive dhe të arsyeshme.<sup>18</sup>

Në bazë të Ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të ligjit përcaktohet se: “*Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi*”.

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim

<sup>15</sup> Ratifikuar me Ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

<sup>16</sup> Ratifikuar me ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002.

<sup>17</sup> Shih: *Sidabras dhe Dëiatas kundër Lituaniës, prg 30.*

<sup>18</sup> Raporti Shpjegues që shoqëron Protokollin 12 të KEDNJ-së, paragrafi 15.

objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, neni 12, pika 1, germa c), parashikon se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimit dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës. Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS<sup>19</sup> gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm. Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin nenin 33, pika 7/1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se : “7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.”

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek pala e akuzuar, e cila duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse subjekti që pretendohet se ka

---

<sup>19</sup> Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njëren nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.<sup>20</sup>

Komisioneri çmon të nevojshme të theksojë se, është pikërisht bazuar në standartin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e padrejtë është shkaku i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime “ *të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave...provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht<sup>21</sup>”.*

Bazuar në analizën e mësipërme rezultoi se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme. Njëkohësisht, sa më sipër, rezultoi e provuar se ankuesi është anëtarë i partisë, Lëvizja Socialiste për Integrim, duke provuar në këtë mënyrë bindjet dhe aktivitetin e tij politik. Ankuesi ka parashtruar se, fakti që bindjet e tij politike janë të kundërta me ato titullarëve të institucionit, ka sjellë si pasojë trajtimin e tij të pafavorshëm duke i dhënë masën disiplinore, duke mostrajtuar ankesën për diskriminim dhe duke i moskonfirmuar statusin e nepunësit civil.

Bazuar në dokumentacionin që disponon nga procedura hetimore, Komisioneri vlerëson se ankuesi e mbart shkakun e sipërpërmendur.

Komisioneri vlerëson se, Kryetari i Bashkisë Berat dhe zv/Kryetari i Bashkisë L.B, i kanë të ekspozuara dhe të provuara aktivitetet e tyre politike, pasi në zgjedhjet vendore të datës 30.06.2019, janë kandiduar dhe mbështetur nga subjekti politik, Partia Socialiste e Shqipërisë.

Bazuar në informacionin e administruar nga Komisioneri në kuadër të ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave të tij për shqyrtimin e ankesave për diskriminim, rezulton se Bashkia Berat ka dhënë masa disiplinore dhe ka ndërprerë marrëdhëniet e punës edhe me punonjës të tjerë, të cilët

<sup>20</sup> [https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-laë-2018\\_en.pdf](https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-laë-2018_en.pdf), fq.232.

<sup>21</sup> GJEDNJ, *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë* (GC) paragrafi 147, (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005). Kjo përsëritet në çështjen e GJEDNJ-së, *Timishev kundër Rusisë* (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39 (ECtHR, *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005), dhe GJEDNJ, *D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178 (ECtHR, *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).

kanë paraqitur ankesë pranë Komisionerit, duke pretenduar veprime diskriminuese dhe largim nga puna për shkak të bindjeve politike<sup>22</sup>.

Në rastin konkret argumentet dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesi janë në përputhje me provat dhe informacionin e administruar dhe krijojnë prezumimin se dhënia e masës disiplinore, mosshqyrtimi i ankesës për diskriminim dhe moskonfirmimi i nëpunësit civil është kryer për shkaqet e pretenduara nga ankuesi.

Nga dokumentet e administruara, rezulton se, në rastin e dhënies së masës disiplinore, ankuesi nuk është njoftuar paraprakisht, për shkeljen e bërë, në mënyrë që të kishte mundësi për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur.

Nga faktet e administruara, Komisioneri vlerësoi se ankuesi është cënuar në të drejtën e tij për një proces të rregullt, pasi ai nuk ka patur në mënyrë efektive të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur në lidhje me arsyet e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës.

Komisioneri duke vlerësuar marrëdhëniet e punës mes drejtuesve të bashkisë dhe ankuesit, ngre dyshimin e arsyeshëm se veprimet e drejtuesve të bashkisë duke penalizuar vetëm G.GJ për mosrealizim të detyrave në kohë, mosshqyrtimit të ankesave për diskriminim dhe moskonfirmimi i nëpunësit civil, kanë qenë veprime të pajustificuara dhe të njëanshme.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit nga Bashkia Berat kundrejt ankuesit dhe si pasojë barra e provës bie tek ky subjekt.

Në këto kushte, për të vërtetuar të kundërtën, Kryetari i Bashkisë dhe Drejtori i Komanduar duhet të përmbushnin dy kushtet e përmendura më sipër.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se Bashkia Berat, dështoi të provonte përpara Komisionerit se:

- Është respektuar procedura ligjore për dhënien e masës disiplinore për ankuesin.
- Të faktonte, mosrealizimin në kohë të detyrave të ngarkuara, nga ankuesi.
- Është përgjigjur me efektivitet ankesave për diskriminim të bëra nga ankuesi.
- Është ndjekur procedura ligjore për konfirmimin e nëpunësit civil.
- Nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar nga ankuesi, që janë bindjet politike dhe trajtimit të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Berat, të konstatuar edhe nga Komisioneri në këtë vendim.

Bazuar në konstatimet e mësipërme, Komisioneri krijon bindjen se G.GJ është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme në procedurën e ndjekur për dhënien e masës disiplinore, mostrajtimit të ankesave për diskriminim dhe moskonfirmimit të nëpunësit civil. Duke iu referuar faktit se, ankuesi është anëtar i subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim,

---

<sup>22</sup> Ankesat e depozituara pranë KMD-së: nr. 139, datë 31.10.2019, nr. 154, datë 05.12.2019, nr. 108, datë 30.09.2020 dhe nr. 45, datë 26.03.2021.



prezumimit se punëdhënësi ka patur dijeni për bindjet e tij politike dhe faktit që Bashkia Berat nuk arriti të provojë se nuk ka patur një trajtim të pafavorshëm dhe se dhënia e masës disiplinore, mostrajtimi i ankesave për diskriminim dhe moskonfirmimi i nëpunësit civil ka patur një shkak të ligjshëm, krijohet bindja se veprimet e Bashkisë Berat kanë qenë të motivuara politikisht. Në këtë mënyrë plotësohet edhe elementi tjetër i nevojshëm për të përcaktuar nëse diskriminimi ka ndodhur, pra lidhja shkakësore.

**Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se shtetasi G.GJ është ekspozuar ndaj një trajtimi diskriminues, nga ana e Kryetarit të Bashkisë Berat, E.D dhe nga Drejtori i Komanduar, L.B, trajtim i cili ka ardhur për shkak të bindjes politike të ankuesit. Për rrjedhojë Kryetari i Bashkisë Berat, E.D dhe Drejtori i Komanduar, L.B kanë shkelur nenet 3/1, nenin 5/1, nenin 12/1/c dhe nenin 13/1/c të ligjit 10221/2020 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.**

Në ankesë, G.GJ ka kërkuar nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit dhe ndalimin e situatës shqetësuese të trajtimit të tij nga ana e Bashkisë Berat. Lidhur me këtë kërkesë, Komisioneri, kostaton se ankuesi me Vendimin nr. 275/2, datë 18.02.2021, është liruar nga shërbimi civil, për shkak të shkurtimit të vendit të punës. Në këto kushte, Komisioneri do konstatojë vetëm veprimet diskriminuese të bëra nga Kryetari i Bashkisë Berat, E.D dhe Drejtori i Komanduar, L.B, pa rekomanduar rregullime.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në bazë të nenin 1, nenin 3/1, nenin 7, nenin 12, pika 1, germat c), nenin 13/1/c, nenin 32/1, gërma c), si dhe nenin 33, pikat 7/1, 10, 11 dhe 12, të ligjit 10221/04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Konstatimin e diskriminimit të shtetasit G.GJ, nga ana e Kryetarit të Bashkisë Berat, E.D dhe Drejtorit të Komanduar të Drejtorisë së Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, L.B, për shkak të bindjes politike gjatë procedurës së dhënies së masës disiplinore, trajtimit të ankesave për diskriminim dhe moskonfirmimit të statusit të nëpunësit civil.

2. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetasit G.GJ, nga ana e Bashkisë Berat, për shkak të bindjes politike gjatë procedurës së përfundimit së marrëdhënieve të punës në shërbimin civil.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**